



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 39, datë 09.07.2026

PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 20, DATË 11.06.2025, PËRSA I PËRKET Z. DANJEL MEHMETI DHE Z. PETRO DEDJA, NR. 21 DATË 11.06.2025, PËRSA I PËRKET Z. AGIM HODO DHE Z. JUVENTUS KODRA SI DHE NR. 36, DATË 09.05.2022, PËRSA I PËRKET Z. SKËNDER ÇUKA

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 11.06.2025 “Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit Bashkiak përsa i përket listave të përfituesve, banorë në banesat individuale, të cilët kanë përfituar nga programi i procesit të rindërtimit të zonës së re për zhvillim, Njësia Administrative Durrës, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 164, datë 19.02.2020, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 21, datë 11.06.2025 “Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit Bashkiak të listës së përfituesve, banorë në pallatet e dëmtuara në Njësitet Administrative Sukth, Katund i Ri si dhe Njesisë Administrative Nr. 3 dhe Nr. 4, Bashkia Durrës, të cilët kanë përfituar nga Programi i Procesit të Rindërtimit të zonës së re për zhvillim, sipas Vendimit të Këshillit të ministrave nr. 164, datë 19.02.2020, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës dhe caktimin e fondit Shqiptar të

Zhvillimit si njësi zbatuese”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 36, datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësine Administrative Rrashbull, Rruga “Gjon Kastrioti”, pallati nr. 39, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së Bashkisë Durrës “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5”, i ndryshuar si dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:



1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 11.06.2025 përsa i përket shpalljes si përfitues të z. Danjel Mehmeti për njësinë e banimit me strukturë 2+1 sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
2. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 11.06.2025 përsa i përket shpalljes si përfitues të z. Petro Dedja për njësinë e banimit me strukturë 3+1 sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 21, datë 11.06.2025 përsa i përket shpalljes si përfitues të z. Agim Hodo për njësinë e banimit me strukturë 2+1 sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
4. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 21, datë 11.06.2025 përsa i përket shpalljes si përfitues të z. Juventus Kodra për njësinë e banimit me strukturë 2+1 sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
5. Miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 36, datë 09.05.2022 përsa i përket shpalljes si përfitues të z. Skënder Çuka për njësinë e banimit me strukturë 1+1 sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit si dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë Ligjore, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARE

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 10.07.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 537/15 prot.

Durrës, më 15 . 07 .2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.39 datë 09.07.2026, “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Vendimet e Këshillit Bashkiak nr.20, datë 11.06.2025, përsa i përket z. Danjel Mehmeti dhe z. Petro Dedja, nr. 21 datë 11.06.2025, përsa i përket z. Agim Hodo dhe z. Juventus Kodra si dhe nr. 36, datë 09.05.2022, përsa i përket z. Skënder Çuka”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi e Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) i ndryshuar “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
ADRIAN GURRA

